



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI JURIDIK

PROJEKTVENDIM

NR. ____, DATË __/__/202__

**PËR DHËNIEN E DAKORDËSISË PËR VAZHDIMIN E PROCEDURËS SË
NDRYSHIMIT TË KATEGORISË SË PËRDORIMIT TË SIPËRFAQES PYJORE
NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR, NË ZBATIM TË VENDIMIT NR.37, DATË
01.08.2023 TË KKT-SË “PËR MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR
OBJEKTIN RESORT TURISTIK LURA 5, FAZA 3, NJËSIA
ADMINISTRATIVE ISHËM, BASHKIA Durrës”**

Në zbatim të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.57/2020 “Për pyjet”, Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 26.01.2017 “Per mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullës kombëtar”, VKM-së nr. 591/2018, VKM nr. 1353 datë 10.10.2008 “Per përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor”, të ndryshuar, VKM nr. 1374 datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave e të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullësor” i ndryshuar, shkresës së Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit Nr. 1667/1 Prot, datë 12.03.2025 si edhe sipas relacionit të hartuar nga Sektori i Pyjeve dhe Kullotave pranë Drejtorisë Ligjore, kryetari i bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të gjykojë dhe shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe,

TË VENDOSË:

1. Dhënie e dakordësisë për vazhdimin e procedurës së ndryshimit të kategorisë së përdorimit të sipërfaqes pyjore nga fondi pyjor kombëtar, në zbatim të vendimit nr.37, datë 01.08.2023 të KKT-së “Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin resort turistik Lura 5, faza 3, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës”.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Pyjeve dhe Kullotave pranë Drejtorisë Ligjore, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

DREJTORIA LIGJORE


Drejtör

Alpeida Rroshi



KRYETAR

Emiriana Sako





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

RELACION

**PËR DHËNIEN E DAKORDËSISË PËR VAZHDIMIN E PROCEDURËS SË
NDRYSHIMIT TË KATEGORISË SË PËRDORIMIT TË SIPËRFAQES PYJORE
NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR, NË ZBATIM TË VENDIMIT NR.37, DATË
01.08.2023 TË KKT-SË “PËR MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR
OBJEKTIN RESORT TURISTIK LURA 5, FAZA 3, NJËSIA
ADMINISTRATIVE ISHËM, BASHKIA Durrës”**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, VKM-së nr. 888, datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacionin përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”, pranë Bashkisë Durrës është protokolluar kërkesa e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Drejtoria e Përgjithshme për Zhvillimin e Mjedisit, Drejtoria e Natyrës dhe Pyjeve nr.1667/1 prot., datë 12.03.2025 nëpërmjet së cilës kërkohet vijimi i procedurave për hartimin e raportit teknik dhe dhënien e dakordësisë nga ana e Këshillit Bashkiak lidhur me heqjen nga fondi pyjor sipas kërkesës të subjektit privat “Lura Group” shpk. “Lura Group” shpk është pajisur me lejen e ndërtimit nr.37, datë 01.08.2023 nga ana e KKT-së “Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin resort turistik LURA 5, faza 3, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës” si dhe VNM paraprake, datë 04.03.2024, me nr.AN130220240017, komisioni 28 “Ndërtim Fshati Turistik, Kompleksi Lura 5”. Bashkia Durrës, për t’i hapur rrugë zbatimit të projektit turistik të miratuar prej 8652.45 m² sipas vendimit nr.37, të KKT-së, është e nevojshme ndryshimi i destinacionit të ngastrës pyjore me nr. 66/c, në ekonominë pyjore Rrotull, kusht i domosdoshëm për vazhdimin procedural administrativ i kërkuar nga aktet ligjore. Gjithashtu, Struktura përgjegjëse për pyjet në ministri, nëse vlerëson se dokumentacioni është i plotë, sipas dispozitave ligjore të VKM-së nr. 888, datë 27.12.2022 përcjell kërkesën për hartimin e raportit tekniko-ekonomik dhe dhënien e dakordësisë, njësisë së vetëqeverisjes vendore, kur sipërfaqja pyjore, objekt i ndryshimit të kategorisë së përdorimit, është në pronësi të saj ose në pronësi private. Ligji nr. 57/2020 “Për Pyjet” përcakton që ndryshimet (heqje/shtesa) të sipërfaqeve nga/në fondin pyjor kombëtar bëhen me:

- a) miratimin e ministrit për sipërfaqe deri në 1 ha;
- b) vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe mbi 1 ha deri në 10 ha;
- c) ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 10 ha.

Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit.

Sa më sipër referuar pikës 6, kapitulli II, të VKM-së 888, ku thuhet "Njësia e Vetëqeverisjes vendore, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e administrimit të kërkesës, përcjell pranë ministrit së përgjegjëse raportin ekonomik së bashku me vendimin e Këshillit Bashkiak i cili jep pëlqimin ose jo për vazhdimin e procedurës së ndryshimit të kategorisë së përdorimit të sipërfaqes pyjore në pronësi të saj ose private", kërkohet dhënia e dakordësisë nga ana e Këshillit Bashkiak për vazhdimin e procedurës së ndryshimit të kategorisë së përdorimit të sipërfaqes pyjore nga fondi pyjor kombëtar, në zbatim të vendimit nr.37, datë 01.08.2023 të KKT-së "Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin resort turistik LURA 5, faza 3, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës".

Ju ftojme në vlerësimin e dakordësisë për vijimin e procedurave nga institucionet e tjera për heqje nga fondi pyjor sipas materialit bashkëngjitur.

Duke Ju falenderuar !

DREJTOR

Almida Broshi

Konceptori: A.Kapidani,

S.Maksuti,